

Kosova dhe Shqipëria:  
Gjendja e kornizës politike  
për rritjen e efikasitetit  
energjitike në ndërtesa

---

Marianna Sobkiewicz,  
Liron Gjocaj, Arion Sauku

Ky dokument është përgatitur në kuadër të projektit “RenovAID – Mbështetje strukturore në shumë nivele për përmirësimin e efikasitetit energjetik në ndërtesat në Kosovë dhe Shqipëri”, pjesë e Iniciativës Evropiane për Klimën (EUKI) të Ministrisë Federale Gjermane për Çështjet Ekonomike dhe Veprimin Klimatik. (BMWK). Programi EUKI zbatohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH. Qëllimi kryesor i EUKI-së është të nxisë bashkëpunimin për klimën brenda Bashkimit Evropian (BE) për të zbutur emetimet e gazeve serrë.

Opinionet e paraqitura në këtë dokument janë përgjegjësi vetëm e autorit(ve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë Federale për Çështjet Ekonomike dhe Veprimin Klimatik (BMWK).


Supported by:



on the basis of a decision  
by the German Bundestag

# RenovAID

Multi-level structural support  
for improving energy efficiency  
in buildings in Kosovo and Albania



# KOSOVA DHE SHQIPËRIA:


Gjendja e kornizës politike për rritjen e efijencës energjitike në ndërtesa

## AUTORË:

Marianna Sobkiewicz (WiseEuropa)

Liron Gjocaj (Instituti për Politika Zhvillimore)

Arion Sauku (Milieukontakt Shqipëri)



# Hyrje

## GJENDJA GLOBALISHT

“Energjia më e gjelbër është energjia që nuk përdorim.” Kjo fjali e shumëcitur shpreh shkurt rolin e efikasitetit energjetic në përshtetimin e tranzicionit të gjelbër. Në vitin 2022, konsumi i energjisë në ndërtesa arriti në 30% të kërkesës botërore për energji. Ndërtesat janë në qendër të vëmendjes për tranzicionin energjetic jo vetëm për shkak të konsumit të lartë energjetic, por dhe për shkak të prirjeve dhe faktorëve vijues:

- ◆ Rritje e shpejtë e sipërfaqes ndërtimore në rang botëror;
- ◆ Kërkesë përherë në rritje për energji për ftohje të mjediseve;
- ◆ Jetëgjatësia e ndërtesave, infrastrukturës për ngrohje-ftohje dhe e pajisjeve që lidhen me to, që nënkupton që vendimet që merren sot për ndërtime dhe blerje do të ndikojnë në përdorimin e energjisë për vitet dhe dhjetëvjeçarët që vijnë.

Konsumi botëror i energjisë për ndërtesat ka pësuar rritje të ngadaltë por të qëndrueshme në dhjetëvjeçarin e kaluar (me një mesatare 1.1% ndërmjet viteve 2010 e 2022) . Ngrohja e mjediseve përbën përdorimin dhe konsumin më të lartë të energjisë në ngrehina. Ndonëse ende dominohet nga lëndët djegëse fosile, elektrifikimi ofron mundësi të mëdha, veçanërisht përmes përdorimit përherë e më të gjërë të pompave të kondicionimit të ajrit, si në njësitë familjare dhe në rrjetet më të gjera të ngrohjes qendrore (lagje, rajone).

## GJENDJA NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Për të lehtësuar integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Europian (BE), më 1999 u ngrit kuadri i Procesit të Stabilizim-Asocimit (PSA) (i fuqizuar më tej më 2003). Ndër disa objektiva, si qëndrueshmëria politike në Ballkanin Perëndimor, synimi i kuadrit të PSA-së është që të ndihmojë vendet që të ngrenë aftësinë e tyre për të marrë dhe vënë në jetë ligjet e BE-së dhe standarde të tjera europiane dhe ndërkombëtare . Që nga shkurti 2024, Kosova ka statusin e kandidatit të mundshëm, ndërsa Shqipëria është një hap më tutje ngaqë mban statusin e kandidatit zyrtar.

Krahasuar me vendet që iu bashkuan BE-së në zgjerimet më të fundit (Kroacia më 2013, Bullgaria e Rumania më 2007, dhe dhjetë vendet që u bënë

1 <https://iea.blob.core.windows.net/assets/dfd9134f-12eb-4045-9789-9d6ab8d9fbf4/EnergyEfficiency2023.pdf>

2 [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/glossary/stabilisation-and-association-process\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/glossary/stabilisation-and-association-process_en)

pjesë e zgjerimit “Big Bang” më 2004), Kosova dhe Shqipëria do të përballen me një sfidë më të madhe ligjore. Legjislacioni i dikurshëm për energjinë, disi modest në vëllim e thellësi, është zgjeruar qenësisht me norma të reja ligjore që synojnë të krijojnë dhe integrojnë jo thjesht tregjet e energjisë në vetvete, por dhe vizionet strategjike të Shteteve Anëtare në lidhje me kalimin e energjisë drejt qëndrueshmërisë.

Kosova dhe Shqipëria janë të dyja palë kontraktuese në Komunitetin e Energjisë (KE) që nga viti 2006. Anëtarësimi në KE ka rol domethënës në rrugëtimin e vendeve drejt anëtarësimit në KE për disa arsye:

- ◆ Harmonizim me standardet e BE-së (politikat, legjislacioni dhe kuadri rregullator për energjinë);
- ◆ Qasje në tregun e brendshëm energjetic të BE-së;
- ◆ Anëtarësimi në KE mund të shpejtojë zhvillimin infrastrukturor në vendet kandidatë në BE (rrjetet e transmetimit dhe të shpërndarjes, sistemet e interkonjeksionit dhe të furnizimit);
- ◆ Mbështetje për reforma në energji (KE ofron mbështetje teknike, programe fuqizimi institucional dhe mbështetje financiare).

**Në këtë raport ne japim një vështrim të përgjithshëm të politikave dhe dokumenteve kryesore ekzistuese në Kosovë dhe Shqipëri, duke përfshirë një vlerësim të shkurtër të përputhshmërisë së tyre me politikat e nivelit europerëndimor.** Ne kemi kryer një analizë të përgjithshme si të burimeve të të dhënave parësore ashtu dhe të atyre dytësore. Të dhënat parësore u mbledhën përmes intervistave me përfaqësues nga administrata publike dhe me ekspertë të politikave energjitike. Veç këtyre, të dhënat dytësore që rrjedhin nga raporte të qeverisë dhe publikime nga Komisioni Europian dhe Komuniteti i Energjisë, janë përdorur për të përfutur një kornizë të fuqishme për analizimin. Për më tepër, janë trupëzuar aty dhe të dhëna sasiore për të shtuar thellësinë dhe saktësinë e gjetjeve që paraqiten në këtë raport.

## KUADRI POLITIK I BE-SË: EFIÇENCA ENERJITIKE DHE NDËRTESTAT

Politika europerëndimore për efikasitetin në energji ka marrë hov në vitet e shkuara. Po ashtu, në rang botëror është vlerësuar si jetike në përshtetimin e tranzicionit energjetic si dhe në nxitjen e sigurisë dhe frytshmërisë energjitike<sup>3</sup>. Ndonëse ecuria në rang botëror është ngadalësuar, BE ka shenjuar një përmirësim me 4.8% në intensitetin energjetic parësor për vitin 2023 (pa folur për rritjen në 8% më 2022)<sup>4</sup>. Njëkohësisht, duhet vlerësuar që ndikimi i politikave


3 <https://iea.blob.core.windows.net/assets/dfd9134f-12eb-4045-9789-9d6ab8d9fbf4/EnergyEfficiency2023.pdf>

4 <https://www.iea.org/reports/energy-efficiency-2023/why-is-energy-intensity-progress-lower-in-2023-despite-significant-policy-action>

dhe i teknologjive të reja nuk është përherë i menjëhershëm, dhe që rritjet në efikasitet arrihen për periudha disavjeçare.

Në vitet e shkuara, Bashkimi Europian ka përparuar në mënyrë domethënëse në politikat e efikasitetit energjetic për të zbutur ndryshimet klimatike dhe për të nxitur qëndrueshmërinë. Grupe normash si Direktiva për Efikasitetin Energjetic (EED), Direktiva për Rendimentin Energjetic në Ndërtesa (EPBD), Administrimi i Bashkimit të Energjisë dhe Rregullorja për Veprimin Klimatik (Rregullorja e Administrimit) dhe Direktiva për Energjitë e Rinovueshme (RED) kanë qenë shtylla në caktimin e synimeve ambicioze dhe masave për nxitjen e kursimit të energjisë ndër vendet anëtare. Figura 1 poshtë paraqet legjislacionin kyç të BE-së në lidhje me efikasitetin e energjisë në ndërtesa dhe përmbledh anët që ndikojnë më drejtpërdrejt politikën e efikasitetit energjetic.

**Figura 1. Legjislacioni kyç në BE për efikasitetin energjetic në ndërtesa**



Burimi: Komisioni Evropian

## RREGULLORJA E ADMINISTRIMIT

Rregullorja e BE-së për Administrimin, e vitit 2018, synon të nxisë aftësinë e Bashkimit për të arritur objektivat e veta për klimën dhe energjinë, duke përfshirë ato që lidhen me efikasitetin energjetic. Aspekte kyçe në politikat e Shteteve Anëtare për efikasitetin energjetic përmbledhin miratimin e planeve kombëtare për energjinë dhe klimën (NECP), që u japin trajtë synimeve, politikave dhe masave të çdo vendi për të garantuar përparim drejt synimeve në mbarë BE-në.

Rregullorja thekson rëndësinë e qasjeve të integruara, bashkërendimit dhe përfshirjes së palëve të interesuara në hartimin dhe vënien në jetë të këtyre planeve. Po ashtu, vë në punë një kornizë për monitorim, raportim në vijimësi, dhe vlerësim të ecurisë, duke mundësuar gjurmim të efektshëm të masave për

për efikasitetin energjetic dhe duke lehtësuar ndryshimet në kohë e sipas nevojave. NECP-të trajtojnë **pesë përmasat e Bashkimit Energjetic**:

1. Shkarbonizimi;
2. Efikasiteti energjetic;
3. Siguria energjeticë;
4. Tregu i brendshëm i energjisë;
5. Kërkimi, risia dhe aftësia konkurruese.

## DIREKTIVA PËR EFIÇENCËN ENERGIJTIKE

TBE ka fuqizuar Direktivën për Efikasitetin Energjetic (EED) për të kufizuar kërkesën për energji. E miratuar fillimisht më 2012, EED u rishikua më 2018 dhe 2023, ku ky rishikim i fundit ngriti ndryshime ambicioze të BE-së për efikasitetin energjetic. EED ngre synimin për efikasitetin energjetic, **duke i detyruar vendet e BE-së që, së bashku, deri në vitin 2030, të garantojnë një pakësim tjetër prej 11.7% në konsumin e energjisë, krahasuar me skenaret e referencës së vitit 2020.**

Përpos kësaj, EED e ndryshuar synon fuqishëm në lehtësimin e varfërisë energjeticë përmes:

- ◆ Kërkesave drejtuar Shteteve Anëtare që të fuqizojnë konsumatorin duke ngritur ndërgjegjësimin për efikasitetin energjetic;
- ◆ Nënvizimit të ngritja e këndeve-me-një-ndalesë për të ofruar këshilla teknike dhe financiare për konsumatorët;
- ◆ Përmirësimit të rregulloreve që lidhen me incentivat për përtëritjen e efikasitetit energjetic, të ndara mes qiramarrësve dhe pronarëve, ose ndërmjet disa pronarëve<sup>5</sup>.

## DIREKTIVA PËR PERFORMANCËN ENERGIJTIKE NË NDËRTESEA

Më dhjetor 2023, ligjvënësit e BE-së arritën një marrëveshje të përkohshme për të riparë Direktivën për Performancën Energjeticë në Ndërtesa (EPBD). EPBD e ndryshuar parashikon masa si:

- ◆ Besueshmëri, cilësi dhe digjitalizim i shtuar i Certifikatave të Performancës Energjeticë;
- ◆ Heqje shkalë-shkalë e kaldajave të vetme (për një shtëpi) që furnizohen me lëndë djegëse fosile, duke nisur me mbylljen e programit të subvencionit për të tilla kaldaja që nga data 1 janar 2025;

5 [https://energy.ec.europa.eu/topics/energy-efficiency/energy-efficiency-targets-directive-and-rules/energy-efficiency-directive\\_en#the-revised-directive](https://energy.ec.europa.eu/topics/energy-efficiency/energy-efficiency-targets-directive-and-rules/energy-efficiency-directive_en#the-revised-directive)

- ◆ Kënde-me-një-ndalesë që u shërbejnë pronarëve të shtëpive, sipërmarrjeve të vogla e të mesme dhe palëve të treta të interesuara, në fushën e rinovimit të energjisë për ndërtesat;
- ◆ Trajektore kombëtare për të pakësuar mesataren e përdorimit të energjisë parësore në ndërtesat e banimit. .

Kërkesa që vendet e BE-së të paraqesin strategji kombëtare të rinovimit u parashikua fillimisht tek EED, por ky parashikim u zhvendos tek EPBD për të garantuar përputhje më të mirë me aspekte të tjera të performancës energjike për ndërtesat. Strategjitë Afatgjata të Rinovimit passjellin:

- ◆ Kornizë tërësore për përshpejtimin e efikasitetit energjetic në sipërfaqen ndërtimore në BE;
- ◆ Gurë kilometrikë për vitet 2030, 2040 dhe 2050;
- ◆ Vështrim i përgjithshëm për sipërfaqen ndërtimore;
- ◆ Veprime që ndihmojnë në lehtësimin e varfërisë energjike;
- ◆ Politika dhe veprime për të nxitur rinovime të thelluara dhe të leverdisshme për ndërtesat<sup>6</sup>.

## DIREKTIVA PËR ENERGJINË E RINOVUESHME

Nisur nga ngritja në vijimësi e ambicjeve të BE-së për transferimin tek energjia e pastër dhe nga nevoja për të përshpejtuar përdorimin e burimeve të përtëritshme, më 2023 u rishikua Direktiva për Energjitikë e Rinovueshme EU/2018/2001. Direktiva e ndryshuar EU/2023/2413 (RED III) hyri në fuqi më nëntor 2023 dhe parashikon një periudhë 18-mujore gjatë së cilës shumicën e dispozitave të saj Shtetet Anëtare do të bëjnë pjesë të ligjeve kombëtare. Një afat më i shkurtër është caktuar për disa parashikime që lidhen me lëshimin e lejeve për burimet e përtëritshme. **RED III ka caktuar një nivel të përgjithshëm për energjinë e rinovueshme prej së paku 42.5%, që do të jetë detyrues për tërë BE-në në vitin 2030<sup>7</sup>.**

Direktiva cakton objektiva në fusha të posaçme për, ndër të tjera, ngrohjen dhe ftohjen e ndërtesave dhe atë qendrore. Parashikimet e reja caktojnë një nivel tregues prej, së paku, 49% pjesë të energjisë së rinovueshme për ndërtesa deri më 2030. FPërpos kësaj, RED III parashikon rritje shkallëzore në nivelet e burimeve të përtëritshme për ngrohje dhe ftohje, me një rritje të detyrueshme prej 0.8% në vit deri në vitin 2026 dhe me 1.1% nga viti 2026 deri më 2030<sup>8</sup>.

6 [https://energy.ec.europa.eu/topics/energy-efficiency/energy-efficient-buildings/energy-performance-buildings-directive\\_en](https://energy.ec.europa.eu/topics/energy-efficiency/energy-efficient-buildings/energy-performance-buildings-directive_en)

7 [https://energy.ec.europa.eu/topics/renewable-energy/renewable-energy-directive-targets-and-rules/renewable-energy-directive\\_en](https://energy.ec.europa.eu/topics/renewable-energy/renewable-energy-directive-targets-and-rules/renewable-energy-directive_en)

8 <https://sustainablefutures.linklaters.com/post/1021py5/european-renewable-energy-directive-red-iii-updated-ambitious-targets-to-boost>




# KORNIZA LIGJORE E KOSOVËS

Sa i takon rrugëtimin drejt BE-së, Kosova sot ka statusin e kandidatit potencial. Vendi ka ecur para në fushën e energjisë. Zhvillimet më të fundit politike përfshijnë miratimin në mars 2023 të një Strategjie Energjie të re, shpalljen më maj 2023 të ankandit të parë të energjisë diellore, dhe vijon investimet në efikasitetin energjetic për ndërtesat publike dhe ato të banimit. .

Figura 2 paraqet një zberthim sektorial të konsumit përfundimtar të energjisë në Kosovë dhe në BE. Shifra prej 48% e konsumit për familje në Kosovë paraqet vlerën më të lartë të konsumit përfundimtar energjetic në të gjitha fushat dhe tejkalon mesataren e BE-së me plot 20%. Veprimtaritë tregtare dhe industriale kapin një vlerë mjaft më të ulët (përkatësisht 18.2% dhe 9.3%); kështu, familjet përbëjnë konsumatorin në të madh të energjisë në ndërtesa. Kjo nënkupton që kursimi i mundshëm i energjisë në sektorin e banimit në Kosovë mund të ketë një efekt veçanërisht të fortë në efikasitetin energjetic në tërësi për sipërfaqen ndërtimore, më të lartë se sa në BE. .

**Figura 2. Konsumi përfundimtar i energjisë sipas fushave, 2022**



Burimi: Zyra Rregullatore e Energjisë e Kosovës (2023); Eurostat (2024)

Shënim: Disa kategori në dy grafikët paraqesin ndryshime për shkak të kufizimeve në të dhëna

Tabela 1 jep informacion për intervistat e kryera për këtë raport; Tabela 2 paraqet një përmbledhje të gjendjes së legjislativës kyç dhe të politikave në lidhje me efikasitetin energjetic në ndërtesa që është vënë në jetë deri më sot në Kosovë, të ndërtuara duke u mbështetur në intervistat dhe në raportet zyrtare.

**Tabela 1. Intervistat**

TE INTERVISTUAR	PERKATESIA	VITE PERVOJE
1	Fondi i Kosovës për Efikasitetin Energjetic	5
2	Ekspert i pavarur energjie	20
3	Ministria e Ekonomisë e Kosovës	10


**Tabela 2. Korniza politike e Kosovës**

POLITIKA	PERSHKRIMI DHE STATUSI
Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (NECP)	Kosova ka dorëzuar Projektplanin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën. Për të mbuluar zbrazëtinë deri në miratimin e NECP, u përgatit një Plan Veprimi Kombëtar për Efikasitetin Energjetic për vitet 2022 - 2025. NECP i Kosovës për vitet 2025-2030 është në etapën e hartimit dhe do të duhet të përputhet me planet e Komunitetit të Energjisë për 2030.
Agjencia për Efikasitetin e Energjisë	Agjencia e Kosovës për Efikasitetin Energjetic vepron si agjenci ekzekutive në varësi të Ministrisë për Zhvillim Ekonomik dhe përgjigjet për vënien në jetë të politikave përkatëse që paraqiten nga ministria.
Planet për efikasitetin energjetic për vitin 2030	Planet për Efikasitetin Energjetic për vitin 2030 përvijohen në projekt NECP dhe, ndër të tjera, vënë në jetë nenet 5 dhe 7 të Direktivës për Efikasitetin Energjetic.
Direktiva për Efikasitetin Energjetic	Kjo është përfshirë në Ligjin për Efikasitetin Energjetic të Kosovës që është duke u ndryshuar për t'iu përshtatur Direktivës së ndryshuar.
Skemat e Detyrueshme të Efikasitetit Energjetic	Vënia në jetë e Direktivës Europiane për Efikasitetin Energjetic në kornizën ligjore të Kosovës përfshin vënien në jetë të skemave të detyrueshme, por mbetet e nevojshme që këto masa të bëhen funksionale, veçanërisht duke marrë parasysh rishikimin më të fundit të EED në vitin 2023.
Strategji Rinovimi Afatgjatë	Strategjia afatgjatë për efikasitetin energjetic (duke përfshirë rinovimin) është bërë pjesë e politikave kombëtare përmes Strategjisë Energjeticë të Republikës së Kosovës për vitet 2021-2030. Kjo strategji shërben si dokument paraprak i NECP, që në vetvete do të çojë përpara gurët kilometrikë të Strategjisë Energjeticë për vitet 2021-2030. Strategjia e Kosovës për Rinovimin në Ndërtim po u nënshtrohet ndryshimeve dhe kërkon vënie të menjëhershme në jetë së bashku me Planin për ndërtesa me gati zero energji.
Veprimi për varfërinë energjeticë	Nuk ka të dhëna zyrtare gjithëpërfshirëse për numrin e qytetarëve të goditur nga varfëria energjeticë, madje nuk ka as përkufizim ligjor për varfërinë energjeticë. Në muajin janar 2024, qeveria kosovare nisi të vërë në jetë subvencione për familjet në nevojë. 40,620 familje që janë kualifikuar në grupin e parë do të përfitojnë nga subvencionet në energji elektrike. Subvencionet jepet në kuadër të Programit për Mbështetjen e Familjeve në Nevojë, që mbështetet financiarisht nga Bashkimi Europian.
Certifikatat e performancës në energji	Certifikatat e performancës në energji përmenden në Ligjin për Performancën Energjetike në Ndërtesa por ende kërkojnë vënie të menjëhershme në jetë.

## KORNIZA LIGJORE E SHQIPËRISË

Figura 3 paraqet një zbërthim sektorial për konsumin përfundimtar të energjisë në Shqipëri dhe në BE. Pjesa e konsumit familjar në Shqipëri, sikurse dhe pjesët për tërë fushat e tjera, janë të krahasueshme me mesataren e BE-së. Duke qenë se paraqet afro një të katërtën pjesë të konsumit përfundimtar të energjisë, sektori i banimit mban potencial domethënës për të rritur ndjeshëm dobinë energjeticë në tërësi.


**Figura 3. Konsumi përfundimtar i energjisë sipas fushave, viti 2022**



Burimi: Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit e Shqipërisë (2022); Eurostat (2024)

Figura 4 paraqet një zbërthim të konsumit përfundimtar të energjisë në ndërtesat shqiptare sipas lëndës djegëse. Të dhënat tregojnë që pjesa e secilës lëndë djegëse nuk kanë pësuar ndryshim të ndjeshëm mes viteve 2005-2019 dhe që burimet e përtëritshme kanë dominuar përdorimin e energjisë në sektorin e ndërtesave në rang vendi.

**Figura 4. Konsumi përfundimtar i energjisë në ndërtesa në Shqipëri sipas lëndës djegëse, 2005–2019**



Burimi: Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit e Shqipërisë (2022)

Tabela 3 paraqet një përmbledhje të gjendjes së legjislacionit kyç dhe të politikave që janë zbatuar në Shqipëri, duke u mbështetur në një intervistë me një përfaqësues nga Agjencia shqiptare për Efikasitetin e Energjisë dhe në raportet zyrtare.

**Tabela 3.**

POLITIKA	PERSHKRIMI DHE STATUSI
Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (NECP)	NECP për Shqipërinë u miratua më dhjetor 2021. Vendi nuk ka paraqitur ndonjë NECP të përditësuar që atëherë.
Agjencia e Efikasitetit të Energjisë	Roli, aftësitë dhe veprimet e AEE-së duhet të fuqizohen më tej.
Plani për efikasitetin e energjisë për vitin 2030	Nivelet e përditësuara duhet të vihen në jetë me adoptimin e NECP vijues 2030.
Direktiva për Efikasitetin e Energjisë	DEE është transpozuar pjesërisht. Agjencia për Efikasitetin e Energjisë po punon për të transpozuar plotësisht Direktivën deri në fund të vitit 2024. Ende nevojitet një vlerësim gjithëpërfshirës për potencialin e bashkëgjenerimit me efikasitet të lartë dhe ngrohjen qendrore.
Skemat Detyruese për Efikasitetin e Energjisë	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë adoptoi DEE-në më mars 2021 duke përfshirë këtu dhe skemat detyruese. Gjithsesi, asnjë veprim nuk është drejtuar posaçërisht drejt sektorit të ndërtesave dhe nuk ka asnjë mekanizëm për të monitoruar dhe/ose vënë në jetë detyrimet. Sipas raportit për Shqipërinë nga Komisioni Europian për vitin 2023, mbetet e nevojshme ngritja e skemës dhe adoptimi i rregulloreve për etiketimin.
Strategjia Afatgjatë e Rinovimit	Strategjia nuk është zgjedhur ende. Puna vijon si pjesë e projektit për Mbështetjen për Zhvillim me Emision të Ulët dhe AEE ka hyrë në partneritet me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim në lidhje me dokumentin.
Veprim për varfërinë energjitike	Ligji shqiptar për Sektorin e Energjisë (GZ 43/2015) parashikon një përkufizim për "klientin në nevojë" (neni 3). Sipas nenit 95, kriteret për nevojën përcaktohen nga Ministria për Çështjet Sociale në bashkëpunim me Ministrinë për Energjinë dhe Ministrinë e Financave, bashkë me Entin Rregullator të Energjisë. Nevoja trajtohet dhe nga politikat për energjinë dhe politikat sociale në përputhje me Strategjinë Sociale të Komunitetit të Energjisë (2013). Gjithsesi, varfëria energjitike si e tillë ende nuk ka një përkufizim dhe/ose as monitorohet rregullisht. Një politikë dhe masa janë bërë pjesë e PKEK, duke i dhënë udhë adoptimit të një përkufizimi, ngritjes së një sistemi kombëtar për monitorimin dhe rekomandimin e masave për çrrënjosjen e varfërisë energjitike duke u mbështetur në përvojat e Shteteve Anëtare të BE-së, studimin e vlerësimit të individëve që përjetojnë varfëri energjitike dhe arsyet që e sjellin atë.
Certifikatat e performancës energjitike	Certifikatat e performancës energjitike janë hedhur që nga shkurti 2021. Të gjitha ndërtesat e reja ose ato ekzistuese që janë duke iu nënshtruar një rinovimi madhor, duhet të përmbushin kërkesat minimale për performancën energjitike. Gjithsesi, mungesa e investimeve publike dhe subvencioneve nga qeveria u pret hovin këtyre përpjekjeve.

## ANALIZA DHE PËRFUNDIMET

Ndërsa Kosova dhe Shqipëria i janë futur bindshëm rrugëtimit drejt anëtarësimit në BE, ato përballen me sfidën për adoptimin dhe vënien në jetë të një legjislacioni përherë në rritje. Ndërkohë që ambicjet e BE-së zhvillohen dhe përshpejtohen, po ashtu shtohet barra legjislative. Një vështrim më i imët në përpjekjet e dy vendeve për të përputhur politikën me standardet e BE-së, shfaq një përfundim të përbashkët, që sfida më madhore shtrihet në vënien në jetë të politikave në tërësi më shumë se sa në vetë transpozimin e legjislacionit - ngaqë në disa raste dispozitat janë përshtatur në ligje por atyre u mungojnë masat zbatuese. Në disa raste, nuk ka as akte nënligjore për të vënë në zbatim dispozitat e parashikuara në ligje.


Raportet nga Komisioni Europian thonë qartë që të dyja vendet kanë përparim ndonëse duket të ketë ndryshim në nivelin e përgatitjes mes tyre. Për Kosovën, KE raporton “njëfarë niveli përgatitjeje” dhe “njëfarë ecurie”, ndërsa Shqipëria raportohet të ketë arritur “mes një niveli përgatitjeje të moderuar dhe të mirë”. Duket se të dyja vendet kanë vonesa në projektimin e PKEK, ndonëse puna vijon.

Të dyja vendeve u mungon përkufizimi i varfërisë energjeticë si dhe të dhënat bazë, ndaj nuk ka masa që do të shërbenin për ta monitoruar. Kjo duket të jetë një nga hendeqet më domethënëse politike, sidomos duke pasur parasysh masat e reja me të cilat BE synon të mbrojë qytetarët në nevojë, sikurse është Fondi i Gjellbër i Klimës.

Njëherazi, nivelet e varfërisë energjeticë në Kosovë dhe Shqipëri janë ngjashëm mbi mesataren e BE-së. Figura 5 shfaq gjetje të përzgjedhura nga Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (SILC), që shfaq nëse njësitë familjare mund të ngrohën banesën aq sa anëtarët ta quajnë të përshtatshme, nëse vërejnë pikim nga çatia, kondensim, krijim myku, ose nëse ia dalin të paguajnë në kohë faturat e shërbimeve publike.

Në anën pozitive, ligjet për klientët në nevojë që Shqipëria dhe Kosova kanë miratuar deri tani përbëjnë një pikënisje për të vendosur masa që synojnë lehtësimin e varfërisë energjeticë.

**Figura 5. Tregues të përzgjedhur SILC për Shqipërinë, Kosovën dhe BE-28, 2020 (% e familjeve)**



● Pamjaftueshmëria për të mbajtur banesën ngrohë mjaftueshëm

Burimi: Eurostat (2024b)

● Popullsia totale që banon në banesa ku çatia pikon, muret, dyshemeja ose themelet me myk, dritaret e prishura

● faturat e shërbimeve që nuk paguhen në kohë

## Referenca

Komuniteti i Energjisë (2023, 1 nëntor). Raporti vjetor i zbatimit për Shqipërinë.

Komuniteti i Energjisë (2023, 1 nëntor). Raporti vjetor i zbatimit për Kosovën.  
[https://www.energy-community.org/dam/jcr:db6d342-ea7d-4677-9a9b-e18f22a1cfad/EnC\\_IR2023\\_Kosovo.pdf](https://www.energy-community.org/dam/jcr:db6d342-ea7d-4677-9a9b-e18f22a1cfad/EnC_IR2023_Kosovo.pdf)

Zyra Rregullatore e Energjisë për Kosovën (2023). Raporti vjetor 2022.  
<https://www.ero-ks.org/zrre/en/publikimet/raportet-vjetore>

Komisioni European (2023, 8 nëntor). Raporti për Shqipërinë, viti 2023.  
[https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD\\_2023\\_690%20Albania%20report.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf)

Komisioni European (2023, 8 nëntor). Raporti për Kosovën, viti 2023.  
[https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/760aacca-4e88-4667-8792-3ed08cdd65c3\\_en?ile-name=SWD\\_2023\\_692%20Kosovo%20report\\_0.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/760aacca-4e88-4667-8792-3ed08cdd65c3_en?ile-name=SWD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf)

Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (2022). Projektstrategjia për Kosovën 2022-2027.  
<https://www.ebrd.com/documents/strategy-and-policy-coordination/draft-kosovo-country-strategy.pdf?blobnocache=true>

Eurostat (2024a). Konsumi përfundimtar i energjisë sipas sektorëve (nrg\_bal\_s).

Eurostat (2024b). Statistika për të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës.

Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit e Shqipërisë (2022). Komunikata e katërt kombëtare e Shqipërisë për ndryshimet klimatike.  
<https://www.undp.org/albania/publications/>

## MBI PROJEKTIN

Duke qenë se ndërtesat zënë pjesën më të madhe të konsumit të energjisë në Evropë, përmirësimi i efikasitetit të tyre të energjisë dhe reduktimi i konsumit të tyre të energjisë janë shtyllat kryesore në ndjekjen e një stoku ndërtesash të dekarbonizuar deri në vitin 2050, duke kontribuar në zbatimin e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane.

Kosova dhe Shqipëria, që të dyja konsiderohen zyrtarisht si kandidatë potencialë për anëtarësim në BE, dhe kanë disa nga stoqet më joefikase të ndërtesave dhe vlerën më të lartë të varfërisë energjetike (respektivisht 40% dhe 37%) në Evropë. Pavarësisht nga planet e tyre për të reduktuar konsumin e energjisë, Kosovës dhe Shqipërisë i mungojnë kornizat adekuate të politikave për të rritur përmirësimet – veçanërisht në sektorin e ndërtesave të banimit – dhe për të mbështetur masat që mund të përshpejtojnë rinovimin.

Duke u mbështetur në analizat e bazuara në dëshmi, projekti u ofron qeverive të Kosovës dhe Shqipërisë rekomandime politikash se si të përmirësojnë efikasitetin energjetik të ndërtesave. Partnerët kosovarë dhe shqiptarë do të ofrojnë ekspertizë bazuar në kontekstet kombëtare dhe angazhohen me grupet e synuara lokale, ndërsa partnerët polakë dhe hungarezë do të ndajnë ekspertizën e tyre në politikat e BE-së. Do të organizohen trajnime, seminare dhe konsultime për t'i ofruar administratave qendrore dhe vendore njohuritë dhe mjetet e nevojshme për të zhvilluar strategji afatgjata rinovimi në përputhje me politikat e BE-së, duke përfshirë Kornizën e Certifikatës së Performancës së Energjisë.

Një fokus i projektit është varfëria energjetike, e cila është veçanërisht e përhapur në Kosovë dhe Shqipëri. Do të zhvillohen rekomandime për politika dhe do u jepen udhëzime autoriteteve vendore dhe qeverisë se si t'u jepet informacion qytetarëve dhe sektorit privat mbi masat e eficiencës dhe të energjisë së rinovueshme. Qeveritë vendore, sektori privat dhe shoqëria civile do të trajnohen për të krijuar zyra me një ndalesë si një mjet për të lehtësuar dhe përshpejtuar rinovimin e ndërtesave miqësore ndaj klimës.

Mbështetja e zbatimit të legjislacionit të BE-së për klimën dhe energjinë në Kosovë dhe Shqipëri mund të ndihmojë gjithashtu në hapjen e rrugës së tyre drejt anëtarësimit në BE.

